



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:087874
Datë: 20.02.2024
Numri i dokumentit: 05347419

C.A.P.nr.1682/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Besnik Bislimaj, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Sh. U., nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, për përbarimin e dokumentit përbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.433/2023, i datës 19.10.2023, më datë 16.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.433/2023, i datës 19.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin Cpc.433/2023, e datës 19.10.2023, ka vendosur si në vijim: I.REFUZOHET, prapësimi i debitorit të përbarimit: SHSKUK me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit Cpc.nr.433/23, të dt.20.06.2023 mbi caktimin e përbarimit, si i pabazuar. II.OBLIGOHET, debitori i përbarimit: SHSKUK në Prishtinë, që të autorizuarit kreditorit të përbarimit t’ia kompensoi shumën prej 156.00€, në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim.”

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, debitori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën e kreditorit dhe ta anulojë aktvendimin Cpc.nr.433/23, të datës 19.10.2023.

Debitori përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të kreditorit, me propozim që ankesa e kreditorit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Sh. U, me datë 06.04.2023, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur propozim për përmbartim pranë përmbartuesit privat Afet Mjeku, për lejin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv, vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, vendimit Nr. 303/2020, të datës 19.05.2020 si dhe Vendimit për Korrigjimin e Gabimeve të IP-së të shkallës së I-rë Nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, ka nxjerrë aktvendimin Cpc.nr.433/23, të datës 20.06.2023, me të cilin e ka caktuar përmbartimin.

Ndaj vendimit për caktimin e përmbartimit, debitori përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me pretendimet se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim për të njëjtën çështje dhe se gjykata më parë ka përfunduar të gjitha procedurat në këtë çështje juridike përmbartimore për të cilat arsye edhe ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovet ndërsa aktvendimi Cpc.nr.433/23, i datës 20.06.2023 të anulohet si i pabazë, i passaftshëm dhe i palejuar ngase kemi të bëjmë me çështje të gjykuar.

Me përgjigje në prapësim, të datës 07.07.2023, kreditori ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit ngase në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar dhe se kreditori ka të drejtë që të paraqes propozim të ri ashtu që në këtë çështje përmbartimore, propozimi për përmbartim është iniciuar me vendim administrativ të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm. Ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar ndërsa aktvendimi me të cilin është caktuar përmbartimi Cpc.nr.433/23, i datës 20.06.2023 të vërtetohet. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit, me aktvendimin e atakuar, ka vendosur që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit, analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet në prapësim, i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se debitori i përmbartimit nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbartimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbartimit. Ndërsa pretendimi se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res iudicata), dhe se me të njëjtin vendim gjykata e ka aprovuar prapësimin dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbartim, një pretendim i tillë për gjykatën është i pa bazuar ngase propozimi për përmbartim është bërë në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, i cili përcakton saktë shumën të cilën debitori obligohet t'ia paguaj kreditorit, rrjedhimisht me këtë dokument përmbartues është bërë vetën në këtë rast propozimi për përmbartim, dhe nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 61, paragrafi 1, pika 1 dhe neni 71, paragrafi 1, pika deri 12 dhe 73 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP).

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit, Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i Inspektoratit të Punës 01Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020 dhe Vendimi Korrigjues nr.01-21-1178, i datës 18.11.2020, në rastin konkret janë dokumente përmbartuese dhe siç parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative” dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbartimit*” sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, e po ashtu i plotëson kushtet nga neni 24 paragrafi 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”* dhe i përmban kërkesat nga neni

27 paragrafi 1 të LPP-së, me të cilin ku përcaktohet se: “Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, andaj edhe pretendimet e debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës përbarimore dhe materiale me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike, sepse gjykata përbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi, përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përbarimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e debitorit të përbarimit se, propozimit për përbarim i kreditori është i pasafatshëm, vërejtë se dokumenti përbarues në bazë të cilit është caktuar përbarimi është nxjerrë në kohën sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, andaj pretendimet e tilla u refuzuan si të pathemelta.

Nuk janë pranuar pretendimet e debitorit lidhur me atë se vendimi i Inspektoratit të Punës nuk paraqet titull ekzekutiv, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit me dispozitën e nenit 24 paragrafi 5 të LPP-së përcaktohet se: “Përbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përbarimin”, ndërsa me Ligjin për Inspektoratin e Punës në Kosovë LIGJI Nr. 2002/9, në nenin 6.4 është përcaktuar se: “Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit”, ndërsa me dispozitën e nenit 144 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji Nr. 05/L - 031, përcaktohet se: “Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues”. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, pasi që në kuptim të dispozitave të lart cituara përbarimi mund të lejohet edhe në rastet kur vendimi i dhënë në procedurë administrative që nuk është bërë përfundimtar vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përbarimin, me çka në rastin konkret ankesa e ushtruar në procedurë administrative ndaj vendimit të nxjerrë në atë procedurë nuk ka pasur efekt suspenziv, gjegjësisht nuk ka shtyrë ekzekutimin e vendimit, ashtu që i njëjti është bërë i ekzekutueshëm nga dita e nxjerrjes së tij, andaj edhe në këtë drejtim mbi bazën e këtij vendimi mund të lejohet përbarimi, pasi që ankesa e paraqitur nuk e ka ndalur ekzekutimin, andaj edhe një pretendim i tillë i debitorit u refuzuar si i pathemeltë.

Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tjera ankimore të debitorit, për të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta, për faktin se në këtë çështje juridike përbarimore përbarimi është lejuar në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020 dhe Vendimi Korrigjues nr.01-21-1178, i datës 18.11.2020, i cili i plotëson kushtet për përbarim dhe është i përshtatshëm për përbarim, e po ashtu paraqet bazë juridike për caktimin e përbarimit dhe rrjedhimisht ankesa rezulton të jetë e pathemeltë të cilën gjykata ankimore vendosi ta refuzojë, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se “*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.1682/2023, më datë 16.02.2024

Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v